

L I G J
Nr.7923, datë 19.4.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7564, DATË 19.5.1992 “PËR TË DREJTËN E
AUTORIT”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 17 ndryshohet si vijon:

“Kohëzgjatja e mbrojtjes

Përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë kre, e drejta morale ruhet përgjithmonë dhe e drejta ekonomike ruhet gjatë gjithë jetës së autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij”.

Kohëzgjatja e veprës të bëhet “70 vjet” edhe në nenet 18 dhe 19 të ligjit.

Neni 2

Neni 26 ndryshohet si vijon:

“Pronësia e të drejtave për veprat audiovizuale

Prodhuesi i veprës audiovizuale është personi fizik ose juridik që merr iniciativën dhe përgjegjësinë për të realizuar veprën.

Kontrata që lidh prodhuesi me kompozitorin dhe autorët e tjerë të një vepre audiovizuale përmban edhe kalimin të prodhuesit të së drejtës së shfrytëzimit të veprës audiovizuale, pa prekur të drejtën morale dhe ekonomike të autorëve.

Vepra audiovizuale quhet e përfunduar, kur është përcaktuar me një marrëveshje të përbashkët varianti përfundimtar ndërmjet autorit ose bashkautorëve dhe prodhuesit.

Shpërblimi i autorit për përdorimin e veprës bëhet për çdo rast dhe për çdo mënyrë shfrytëzimi”.

Neni 3

Neni 41 ndryshohet si vijon:

“Agjencitë për të drejtën e autorit

Autorët mund t’i mbrojnë vetë të drejtat e tyre. Kur këto të drejta nuk mund të ushtrohen nga ata vetë, kanë të drejtë të themelojnë “agjenci” për mbrojtjen e të drejtave të tyre në mënyrë kolektive. “Agjencitë” e autorëve janë shoqëri private ortakësh që nuk ndjekin qëllim fitimi e që udhëhiqen nga statutet dhe rregulloret e përgjithshme në funksionimin e tyre. Agjencitë krijohen sipas degëve të artit”.

Neni 4

Neni 42 ndryshohet si vijon:

“Aktet që rregullojnë veprimet e agjencive

Agjencitë e mbështetin veprimtarinë e tyre mbi këtë ligj, mbi akte të tjera ligjore e nënligjore, si dhe mbi statutet dhe rregulloret e tyre të brendshme të miratuara nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.

Neni 5

Neni 43 ndryshohet si vijon:

“Pranimet në agjenci

Agjencitë pranojnë për bashkëpunim sipas degëve të artit të gjithë autorët, trashëgimtarët e tyre, prodhuesit e disqeve, të kasetave a të filmave dhe ata që kanë autorësinë.

Atributet prerogative të agjencive përcaktohen me votim të hapur në Asamblenë e Përgjithshme që funksionin sipas statuteve dhe rregulloreve të përgjithshme, të hartuara nga agjencitë dhe të miratuara nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.

Neni 6

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“Përcaktimi i tarifave

1. Tarifat për përdoruesit e pronësisë artistike nga entet buxhetore dhe jobuxhetore rregullohen sipas ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat” ose me kontrata ndërmjet përdoruesve dhe agjencive të autorëve të krijuara sipas degëve të artit.

Përdoruesit e pronësisë intelektuale në fushën e artit dhe kulturës, buxhetore ose jobuxhetore, brenda datës 15 dhjetor të çdo viti paraardhës detyrohen të përfundojnë kontrata me shoqëritë e autorëve, të përcaktojnë detyrimet e palëve dhe tarifat që do t’u paguhen këtyre shoqërive të autorëve për vitin pasardhës.

Përdorimi i veprave letrare pa kontratë dhe pa autorizimin e shoqërive të autorëve përbën shkelje të së drejtës së autorit dhe sjell përgjegjësi penale.

2. Tarifat e shpërndarjes caktohen pas diskutimit të autorëve me komisionet dhe pasi miratohen nga këshillat e administrimit të agjencive të autorëve”.

Neni 7

Neni 45 ndryshohet si vijon:

“Kriteret e administrimit të të ardhurave

Agjencitë administrojnë në mënyrë rreptësisht të barabartë të gjitha të drejtat që u janë dhënë a besuar. Ato respektojnë parimin që çdo anëtarë të marrë pjesën që i takon nga përdorimi i veprës.

Këto honorare shpërndahen çdo vit, çdo 6 ose 3 muaj për secilin autor a bashkautor.

Agjencitë mbikëqyren nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Përfaqësuesit e autorizuar prej tij asistojnë në mbledhjet e agjencive dhe ndërhyjnë vetëm në rast të shkeljeve të akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e tyre”.

Neni 8

Neni 46 ndryshohet si vijon:

Funksionet e agjencive të autorëve

Agjencitë e autorëve kryejnë këto funksione:

a) hyjnë në bisedime për kushtet dhe honoraret që do të paguhen dhe lëshojnë autorizime për veprime që përfshihen nga të drejtat ekonomike përjashtimore të administruara prej agjencive;

b) mbledhin honoraret për autorizimet e përmendura në pikën (a);

c) u shpërndajnë autorëve honoraret e mbledhura;

ç) kryejnë veprime të tjera, për të cilat janë autorizuar nga autorët në përputhje me nenin 48 për ushtrimin e të drejtave ekonomike përjashtimore që administrojnë”.

Neni 9

Neni 47 ndryshohet si vijon:

“Garancitë për funksionimin e agjencive të autorëve

Administrimi i të drejtave sipas nenit 46 nuk duhet të kufizojë të drejtat ekonomike përjashtimore të administruara nga agjencitë e autorëve. Për të garantuar, parandaluar garantimin e

kufizimeve të tilla, të gjitha vendimet për metodat e rregullat e mbledhjes e të shpërndarjes së honorareve, si dhe për aspekte të tjera të rëndësishme të veprimtarive administrative të agjencive, merren nga autorët që mbrohen nga agjencitë.

Autorëve, të drejtat e të cilëve administrohen nga agjencitë, u jepet informacion i rregullt, i plotë dhe i hollësishëm për veprimtarinë e agjencisë së tyre, me qëllim që të ushtrojnë të drejtat e tyre.

Pa autorizimin e autorëve, të drejtat e të cilëve administrohen drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, asnjë honorar i mbledhur nga agjencitë e autorëve nuk mund të përdoret për qëllime të tjera, përveç qëllimeve që kanë të bëjnë me mbulimin e kostos aktuale të administrimit të të drejtave në fjalë dhe shpërndarjes së pjesës së honorareve që mbeten pas zbritjes së kostos së sipërpërmendur.

Sasia e honorareve të mbledhura nga agjencitë e autorëve, pas zbritjes së kostos aktuale të administrimit, tatimit mbi fitimin sipas ligjit dhe zbritjeve të mundshme që vetë autorët e autorizojnë, u shpërndahet autorëve në përpjesëtim sa më të drejtë me përdorimin aktual të veprave të tyre”.

Neni 10

Në nenin 51, në paragrafin e parë shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“Për veprat e pronësisë intelektuale në fushën e artit që janë krijuar para daljes së këtij ligji, përdorimi i tyre të bëhet sipas dispozitave të përcaktuara në këtë ligj nën rezervën që të drejtat ekonomike të realizohen pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara”

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1096, datë 2.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha